VENDIM
Nr.587, datë 10.8.2011

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, NË FORMËN E HUAPËRDORJES *ME ÇMIMIN 1 EURO*, TË NJË PJESE TË TRUALLIT TË NDËRMARRJES SË QYMYRGURIT VALIAS, KAMËZ, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 87587 M^2, SHOQËRISË "THE AMERICAN INTERNATIONAL SCHOOL SYSTEM-ALBANIA" (AISS), SHPK

(*Ndryshuar me VKM nr. 609, datë 11.9.2012)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të aktit normativ, nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008 dhe të neneve 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, në formën e huapërdorjes *me çmimin 1 euro*, të një pjese të truallit të ndërmarrjes së qymyrgurit Valias, Kamëz, rrethi Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 87 587 (tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) m^2, sipas genplanit bashkëlidhur, shoqërisë "The American International School System –Albania" (AISS) sh.p.k., për ndërtimin e një kampusi universitar.

2. Autorizohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për lidhjen e kontratës përkatëse *me afat 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet.*

3. Kontrata e nënshkruar do të hyjë në fuqi para se të ratifikohet nga Kuvendi.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha